



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr. i Protokollit: 02/687
24/06/2025

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Godanc i Poshtëm dhe i Epërm

E hënë, më 09 qershor 2025

Kohëzgjatja e takimit: 19:45 – 21:40

Vendi i takimit: SHF “ Hasan Prishtina”, Godanc i poshtëm dhe i Epërm

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryetari i Komunës – Qemajl Aliu, Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi – Grejtalb Emini, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – Besnik Ahmeti, Drejtoresha e Drejtorisë se Zhvillimit Ekonomik – Frosina Berisha Ahmeti si dhe Asambleisti -Besnik Seferi.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028

Kryetari i Komunës z.Qemajl Aliu: Mirë se erdhët në takimin e sotëm dhe faleminderit që keni gjetur kohë të jeni pjesë e jonë. Sot jam këtu bashkë me bashkëpunëtorët e mi: Kryesuesin e Kuvendit, Adnan Ademi; Gentiana Mehmeti nga kabineti im; drejtorin e Financave, Besnik Ahmeti; drejtoreshën e Zhvillimit Ekonomik, Frosina Berisha Ahmeti; drejtorin e Infrastrukturës, Grejtalb Emini, si dhe asambleistin Besnik Seferi.

Jemi këtu, si çdo vit, në kuadër të qarkores së parë buxhetore. Siç ju kemi premtuar, buxhetin e ndërtojmë duke marrë kërkesa direkte nga qytetarët, pa dallime gjeografike, politike apo të tjera. Këto kërkesa, së bashku me premtimet tona, përbëjnë dy shtyllat kryesore të planifikimit buxhetor. Tani është momenti që kushdo që ka ndonjë kërkesë apo nevojë, ta paraqesë këtu që ajo të buxhetohet në shtator dhe të implementohet në pranverën e viti të ardhshëm.

Siç e dini, buxheti për investime kapitale të komunës sillet rrëth 2.5 milionë euro, edhe pse kemi sfida me borxhe të trashëguara dhe me kontrata kolektive. Megjithatë, jemi munduar që këto mjete t'i ndajmë në mënyrë të barabartë për secilin fshat, sipas numrit të popullsisë.

Faleminderit punës së mirë që është bërë, kemi pasur edhe një mbështetje të jashtëzakonshme qeveritare, të tillë që Shtimja nuk e ka pasur ndonjëherë më parë.

Kemi dërguar projekte në ministri dhe në Zyrën e Kryeministrat, dhe Shtimja është përkrahur në këto tre vitet e fundit.

Sot jemi këtu për të dëgjuar kërkesat e secilës lagje. Ato do të evidentohen, do të votohen në shtator, do të buxhetohen dhe implementimi do të nisë në pranverën e ardhshme. Kjo ka ndodhur

çdo vit dhe do të ndodhë po njësoj edhe këtë vit dhe vitin tjetër. Kërkesat që keni, mund t'i paraqisni sot. Ne jemi këtu për t'ju dëgjuar dhe për t'ju përgjigjur në çdo pyetje apo shqetësim që keni.

Kërkesat e banorëve të fshatit :

- **Zejnullah Mustafa** : Nje rrugë ka mbetur pa u rregulluar nga bunari i Metushit deri në arat tonë, të bëhet rrugë e arave (Lidhavi i Hafirit).
- **Burim Fazliu**: Dua të ndihmoj me disa kërkesa dhe ide, disa më prioritare e disa më sekondare, por të gjitha të nevojshme për fshatin.

Fillimi, ju përgëzoj për rrugën "17 Shkurti", por ka mbetur pjesa e lumenj pa ndërtuar, do të ishte mirë të vendoset si prioritet. Një kërkesë tjetër është për rrugën që del te mësuesi Shaban dhe lumi. Kanë filluar disa kanale ujite, por kanë mbetur në gjysmë, duke shkaktuar probleme për bujqit me grumbullimin e ujit (rreth 300 m kanale kulluese).

Ruga Kozhinca ka nevojë për trotuar. Tek fusha e Hajdarit të ndërtohet një park ose fushë sportive.

Hapësirat publike të pastrohen nga barnishet.

- **Osman Xhemajli** : Të pastrohet trotuari me bager (Trotuari lart)
- **Salih Ramadani**: Nuk kemi kanalizim, kanë ardhur dy herë për rregullimin e kanalizimit mirëpo banorët nuk po lejojn që kanalizimi të kaloj në oborret e tyre, po kemi problem me erën shumë te keqe.

Zgjerimi i rrugës Zborc-Godanc.

- **Adem Ramadani**: Kjo kërkesë është e kahëmotshme për kanalizim.
Godanci i Epërm e kemi një problem me ujin e pijes, ujin e pagujam mirëpo ujë nuk kemi. Të rregullohet rruga "Agrazhda", 500m, segment i rrugës "Agim Ramadani"
Prej urës deri tek ura tjetër të bëhen disa mbrojtëse apo ansore të metalit (85m).

- **Hysni Rashiti**: Pse nuk zgjati irregullimi i lumenj me tejë?
Të rregullohet trotuari nga lumi deri tek asfalti tek fusha e sportit (150 trotuar).
- **Valmir Bislimi**: Të rregullohet kanalizimi nga Besniki deri në dalje të Tranzitit (350m kanalizim).

Po ashtu po kemi problem edhe me rrymë, është shumë e dobët.

- **Neriman Ismajli**: Kemi probleme me kanalizim, pasi që gypi është bllokuar, këte vit është ndërhyr dhe është rregulluar në disa vende, por nëse ka mundësi të intervenohet prap pasi që dimrit mund te kemi prap probleme, dmth të bëhet rindërtimi i kanalizimit tek rruga "Dëshmorët e Godancit".

Tek shtëpija e të pamës të bëhet një park.

- **Nebih Maksutaj**: Ruga "Muhaxherija", të zgjerohet ose të bëhet një troruar.
- **Beqir Sadiku**: Të ndërtohet një rrugë për arat.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti












REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në: Godanc
Date: 09.06.2025

| Nr | Emri dhe Mbiemri | Nenshkrimi |
|----|------------------|------------|
| 1 | Hysni Rashiti | Nesli |
| 2 | HALIL HYSNI | Jhey |
| 3 | QAZIM HYSNI | Ghej |
| 4 | Selim Romodani | Selim |
| 5 | ERIM MUSTAFI | Amilla |
| 6 | ZEJNULLA MUSTAFI | Zellija |
| 7 | Foton Shogiri | Shogiri |
| 8 | SHEQ ELEZI | Vh. Elezi |
| 9 | Milosm Elez | Elez |
| 10 | ENVER MUSTAFI | Edhem |
| 11 | Beyih Sadikaj | Beyih |
| 12 | Neriman Temayli | Temayli |
| 13 | Aleem Tomodani | Aleem |
| 14 | Isak Gasli | Isak |
| 15 | Gobit Arben | Arben |
| 16 | Aleem Aleem | Aleem |
| 17 | Dardan Kafili | Dardan |

| | | |
|----|-----------------|--|
| 18 | Bujor Sadiki |  |
| 19 | BESNIK QAYILI |  |
| 20 | MUSTAFA MUSTAFA |  |
| 21 | BESJAN QAMILI |  |
| 22 | Neriman ISMAJLI |  |
| 23 | BURIM FAZLIU |  |
| 24 | VALMIR BISCIMI |  |
| 25 | OSMAN XHEMAJLI |  |
| 26 | LARINOT HALIZI |  |
| 27 | Allijon Shabani |  |
| 28 | Gazmend Aliu |  |
| 29 | | |
| 30 | | |
| 31 | | |
| 32 | | |
| 33 | | |
| 34 | | |
| 35 | | |
| 36 | | |
| 37 | | |
| 38 | | |
| 39 | | |
| 40 | | |
| 41 | | |